



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 31/2011
Prishtinë, më 20.09.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-202

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha- Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka, Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli –MI; Enis Berisha-ARH; Ukë Gashi- ZPRK; Florije Kryeziu- UNICEF Junkt; Isuf Zejna- KDI; dhe Sanije Berisha – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Brikena Hoxha, konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.09.2011;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës;
4. Plotësim -ndryshimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13 .09.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 13.09.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-63 për hekurudhat e Kosovës

Kryetari –Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, ia kaloi fjalën deputetes Sala Berisha – Shala, kryesuese e grupit punues.

Sala Berisha – Shala – si kryesuese e grupit punues e Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër, për shkak të volumit të projektligjit dhe t’i jepet edhe një rast grupit punues të mbledhet për ta shqyrtuar pjesën e mbetur të neneve.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës për mbledhjen e radhës.

4. Plotësim- ndryshimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se kur e kemi hartuar Planin e punës të Komisionit për vitin 2011, në fillim të mandatit dhe të kësaj Legjislature, jemi pajtuar që kohë pas kohe të inkorporohen propozime dhe ndryshime, për çështjet e ngritura nga ana e anëtarëve të Komisionit. Po ashtu është plotësuar edhe Strategjia Legjislative e Qeverisë dhe shihet se kemi edhe katër Projektligje që janë shtuar si: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e turizmit; për metalet e çmuara; për tregtinë me naftë dhe Projektligji për pengun. Prandaj përveç shqyrtimit të Projektligjeve, ne do të vazhdojmë me vizita nëpër terren për t’i monitoruar zbatimin e ligjeve dhe do të organizojmë dëgjime publike, që i përkasin fushës së Komisionit.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet plotësim ndryshimi dhe plotësimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit